



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 959/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Savez Kosovskih Serbska (SKS) dega në Graćanicë, paraqitur kundër subjektit politik Građanska Inicijativa Serpska (G.I Serpska) dega në Graćanicë, për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 26.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Savezi Kosovskih Serbska (SKS) dega në Graćanicë.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.11.2013 nga subjekti politik SKS dega në Graćanicë, ku pretendohet se në institucionin e “Ndihmës së Shpejtë” përkatësisht në objektin publik në Lapna Sellë, janë vendosur pllakatat me porosi parazgjedhore të subjektit politik G.I Srpska, gjë që e cila është në kundërshtim me rregullat zgjedhore dhe ndikon direkt në të punuarit dhe në pacientët e “Ndihmës së Shpejtë” . Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtresit të ankesës ka bashkangjitur si provë dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

### **ankesa është e palejuar**

PZAP-i, duke u bazuar në dispozitat e nenit 33 të LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ashtu siç parashihen në pikat a), b), c), d) të këtij neni, po ashtu me nenin 44 të LZP-së, 44.1 pikat a), b), c) ju përcaktohen të drejtat subjekteve politike për veprimet e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, mirëpo meqenëse pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës janë zhvilluar para datës së caktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me dt. 01.12.2013, siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura ligjore, prandaj nuk mund të sanksionohen pretendimet e parashtresit të ankesës ngase veprimet e ndërmarra nga Građanska

Inicijativa Serpska (G.I Serpska) duke i përdorur pllakatat me porosi parazgjedhore të subjektit politik G.I Serpska nuk parashihen me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as me Rregullat Zgjedhore të PZAP-it që të ndërmer masa ligjore para fillimit të fushatës zgjedhore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**

Anr. 959/2013 më datën 26.11.2013.



***Këshill juridike:*** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,